

VENDIM
Nr. 129, datë 2.3.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 548, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, TË RREGULLAVE E PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E PENSIONEVE SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 15 e 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 1, të vendimit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në ndarjen e parë “Institucione kushtetuese e të pavarura”, pas emërtesës “Avokati i Popullit”, shtohen emërtesat e mëposhtme:

- Kolegji i Posaçëm i Apelimit;
- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit;
- Komisionerët Publikë;
- Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar;
- Shkolla e Magjistraturës;
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë;

b) në ndarjen e dytë “Institucione të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” hiqet emërtesa “Këshilli i Lartë i Drejtësisë” dhe shtohen emërtesat e mëposhtme:

- Komisioni i Prokurimit Publik;
- Akademia e Shkencave;
- Instituti i Statistikave;

c) në ndarjen e tretë “Institucione në varësi të Kryeministrit” hiqen emërtesat e mëposhtme:

- Komisioni i Prokurimit Publik;
- Akademia e Shkencave;
- Instituti i Statistikave.

2. Në lidhjen nr. 2, që përmendet në pikën 2, të vendimit, bëhen këto shtesa:

a) për “Grupin e parë”, në pikën 8 bëhen shtesat e mëposhtme:

- në shkronjën “a” shtohen emërtesat “Kryetar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit” dhe “Kryetar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, “Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor”, “Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, “Komisioneri Publik” dhe “Drejtues i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”;

- në shkronjën “b” shtohen emërtesat: “Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, “Komisioner i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, “Anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor”, “Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, “Inspektori i Lartë i Drejtësisë” dhe “Drejtor i Shkollës së Magjistraturës”;

b) për “Grupin e dytë”, në pikën 9 bëhen shtesat e mëposhtme:

- Në shkronjën “a” shtohen emërtesat: “Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, “Sekretar i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, “Kancelar i

Komisionerëve Publikë”, “Sekretar i Përgjithshëm i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, “Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor”, “Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, “Magjistrat” dhe “Pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës”;

- në shkronjën “a”, në nënndarjen “ ... dhe persona të tjerë të barazuar me ta, si më poshtë: ...” shtohet emërtesa “Kancelar në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”;

- në shkronjën “b” shtohet emërtesa: “Kryetar në Komisionin e Prokurimit Publik” dhe “Inspektor jomagjistrat në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

- në shkronjën “d” shtohen emërtesat: “Këshilltar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, “Këshilltar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, “Këshilltar i Komisionerit Publik”, “Kancelar në Shkollën e Magjistraturës”, “Nënkryetar dhe anëtarë në Komisionin e Prokurimit Publik”.

II. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama